



TURIZMI DHE MJEDISI MES PREMTIMIT DHE ZBATIMIT

RAPORT MONITORIMI

Mars 2025



QENDRESA QYTETARE

NED NATIONAL
ENDOWMENT
FOR
DEMOCRACY
SUPPORTING FREEDOM AROUND THE WORLD

www.qeverisja.qq.com.al

AUTOR
SERONA KOLAVERI

TABELA E PËRMBAJTJES

1. HYRJE	3
2. ANALIZA DHE PROGRESI I PREMTIMIT	4
3. MJEDISI	15
4. GJETJET KRYESORE	18
5. REKOMANDIME	20
6. REFERENCA	21



1. HYRJE

Partia Socialiste, gjatë fushatës zgjedhore të vitit 2021, paraqiti një sërë premtimesh dhe angazhimesh të rëndësishme për zhvillimin e turizmit dhe mbrojtjen e mjedisit në Shqipëri. Qëllimi kryesor i këtyre premtimeve ishte modernizimi i infrastrukturës turistike, promovimi i turizmit të qëndrueshëm dhe siguria e një menaxhimi të përgjegjshëm të resurseve natyrore të vendit. Me kalimin e kohës dhe përpara vitit 2025, është e rëndësishme të shqyrtojmë dhe analizojmë me kujdes se cilat nga këto premtime janë realizuar dhe cilat ende mbeten në pritje për t'u realizuar. Ky raport ka për qëllim të ofrojë një vlerësim të thelluar dhe të argumentuar mbi progresin e këtyre iniciativave, duke identifikuar zhvillimet kryesore të ndodhura deri më tani, sfidat dhe pengesat që janë hasur gjatë implementimit të projekteve, si dhe rekomandimet për përmirësimin e politikave dhe strategjive në fushën e turizmit dhe mbrojtjes së mjedisit. Një vlerësim i tillë është i nevojshëm për të kuptuar se sa afër kemi arritur në realizimin e objektivave të parashikuara dhe çfarë mund të bëhet më shumë për të përmbushur pritshmëritë e publikut dhe angazhimet e qeverisë në këtë drejtim.

Ky raport monitoron realizimin e premtimeve dhe angazhimeve të Partisë Socialiste lidhur me zhvillimin e turizmit dhe mbrojtjen e mjedisit në Shqipëri gjatë periudhës 2021–2025. Pjesa kryesore e analizës përqëndrohet në vlerësimin e progresit të arritur deri më tani, përfshirë realizimin e projekteve të infrastrukturës turistike, promovimin e turizmit të qëndrueshëm dhe menaxhimin e resurseve natyrore. Gjithashtu, raporti do të shqyrtojë sfidat dhe pengesat që kanë ndikuar në realizimin e këtyre iniciativave, duke ofruar rekomandime për përmirësimin e politikave të ardhshme. Në këtë kuadër, do të analizohen të dhënat statistikore dhe rezultatet konkrete të ndodhura deri në këtë periudhë, duke ofruar një pasqyrë të qartë mbi përmbushjen e objektivave të parashikuara.

Nr.	Premtimi elektoral
1	Shteti shqiptar do të subvencionojë operatorët turistikë
2	Paketë unike kombëtare për promovimin ndërkombëtar të destinacioneve, paketë në të cilën shteti shqiptar do të investojë 10 milionë Euro çdo vit
3	Agroturizmi do të mbështetet jo vetëm financiarisht, por edhe me harta, rrugë, infrastrukturë lokale, promovim unik
4	Muzeu i ri Etnografik në Gjirokastrë dhe bypass i zonës historike
5	Muze historik në Tepelenë
6	Qendër e re turizmi në Korçë

Burimi: Partia Socialiste e Shqipërisë

2. ANALIZA DHE PROGRESI I PREMTIMIT

2.1. Shteti shqiptar do të subvencionojë operatorët turistikë

Ky premtim kishte si synim mbështetjen e operatorëve turistikë për të lehtësuar ndikimin e pandemisë dhe për të përmirësuar shërbimet e tyre. Sipas të dhënave të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, janë alokuar një sërë fondesh për operatorët turistikë, por ka pasur vonesa në shpërndarjen e tyre. Në vitin 2022 u publikua një program subvencionimi për bizneset turistike, por ndikimi i tij ka qenë i kufizuar.

2.1.1 Shpenzimet e Planifikuara dhe Faktike për Turizmin

Tabela 1: Shpenzimet për Turizmin – 2024

Kategoria e Shpenzimeve	Shpenzimi i Planifikuar (Miliardë Lekë)	Shpenzimi Faktik (Miliardë Lekë)	Përqindja e Shpenzimeve të Realizuara
Investime në Infrastrukturë Turistike	80.0	45.0	56.25%
Subvencione për Operatorët Turistikë	10.0	3.5	35%
Promovimi dhe Marketingu i Turizmit	20.0	10.0	50%
Mbështetje për Bizneset e Vogla	18.5	8.0	43%

Burimi: Ministria e Financave (Përpunim i autorit)

Shpenzimi për turizmin në vitin 2024 ishte më i ulët se sa ishte parashikuar, me një realizim prej 56.25% për investimet në infrastrukturën turistike dhe 35% për subvencionet ndaj operatorëve turistikë.

Pjesa më e madhe e fondeve të planifikuara për subvencione u shpërndanë në mënyrë të kufizuar dhe kryesisht për operatorët më të mëdhenj të turizmit, duke lënë pas shumë operatorë të vegjël që mund të kontribuonin në zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm dhe diversifikimin e ofertës turistike.

Ky është një tregues i qartë se premtimi për subvencionimin masiv të operatorëve turistikë nuk është realizuar në mënyrën e duhur.



2.1.2 Pjesëmarrja e Shqipërisë në Panaire dhe Aktivitetet Ndërkombëtare të Turizmit

Tabela 2: Pjesëmarrja e Shqipërisë në Panaire Ndërkombëtare

Panairi Ndërkombëtar	Viti 2022	Viti 2023	Viti 2024 (Plani)	Operatorë Turistikë Pjesëmarrës
ITB Berlin	15	20	25	10
WTM London	10	15	20	8
Fitur Madrid	12	18	25	5
Panaire të Tjera	8	12	15	7

Burimi: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (Përpunimi i autorit)

Pjesëmarrja në panaire ndërkombëtare ka qenë një mundësi e rëndësishme për të promovuar destinacionet turistike të Shqipërisë. Megjithatë, operatorët më të vegjël kanë pasur mundësi të kufizuara për t'u përfshirë, pasi numri i pjesëmarrësve të operatorëve turistikë është ende i ulët për vitin 2024.

Ky fakt tregon se mbështetja financiare dhe logjistike për operatorët turistikë të vegjël është e pamjaftueshme dhe një pjesë e madhe e fondeve dhe mundësive janë kanalizuar te operatorët më të mëdhenj, siç ishte parashikuar nga kritikrat që lidheshin me premtimet për mbështetje.

2.1.3 Raporti për Përdorimin e Fondit për Subvencionet e Operatorëve Turistikë

Tabela 3: Alokimi i Fonduar për Operatorët Turistikë në Vitin 2024

Kategoria e Mbështetjes	Fondet e Planifikuara (Miliardë Lekë)	Fondet e Shpenzuara (Miliardë Lekë)	Përqindja e Përdorimit të Fondit
Subvencione për promovim	4.0	1.5	37.5%
Subvencione për infrastrukturë	5.0	2.0	40%
Trajnime për operatorët	1.0	0.3	30%

Burimi: Kontrolli i Shtetit (Përpunim i autorit)

Nga të dhënat e shpenzimeve vihet re se përdorimi i fondeve të dedikuara për mbështetje të operatorëve turistikë është shumë më i ulët se sa ishte parashikuar.

Vetëm 37.5% e fondeve të planifikuara për promovimin e turizmit janë shpenzuar dhe ky raport i ulët sugjeron një dështim në realizimin e premtimit për subvencionimin e operatorëve turistikë.

Kjo tregon gjithashtu se qeveria nuk ka siguruar mbështetje të qëndrueshme për operatorët turistikë, veçanërisht për ata që operojnë në zona më të vogla ose që kanë nevojë për trajnime dhe mbështetje më intensive.

2.1.4 Të dhënat për rritjen e trizmit në Shqipëri dhe pjesëmarrjen e operatorëve të vegjël

Tabela 4: Rritja e Turizmit në Shqipëri dhe Pjesëmarrja e Operatorëve të Vegjël

Viti	Numri i Turistëve Ndërkombëtarë	Operatorët Turistikë të Aktivizuar	Rritja e Operatorëve të Vegjël (%)
2022	7.8 milionë	150	5%
2023	8.3 milionë	160	6%
2024	8.5 milionë	170	8%

Burimi: INSTAT (Përpunim i autorit)

Rritja e numrit të turistëve është një tregues pozitiv për industrinë e turizmit në Shqipëri, por pjesëmarrja e operatorëve turistikë të vegjël është ende e ulët, duke reflektuar dështimin e politikave të mbështetjes për operatorët më të vegjël.

Ndërkohë që turizmi ka pasur rritje, operatorët e vegjël, që mund të ofrojnë eksperiencë unike dhe diversifikuese, mbeten të margjinalizuar, duke i lënë më shumë mundësi operatorëve të mëdhenj të turizmit që mund të kenë më shumë mbështetje financiare.

Nga analiza e të dhënave të paraqitura, është e qartë se premtimi elektoral për subvencionimin e operatorëve turistikë nuk është realizuar. Shpenzimet e planifikuara për sektorin e turizmit janë ulur, ndërkohë që shumica e fondeve janë përqendruar tek operatorët më të mëdhenj, duke lënë pas shumë operatorë të vegjël që mund të kontribuonin në zhvillimin e turizmit. Për më tepër, pjesëmarrja në aktivitete ndërkombëtare dhe shpërndarja e fondeve për promovim kanë qenë të kufizuara, duke lënë një hendek midis premtimeve dhe realizimit.



2.2 Paketë unike kombëtare për promovimin ndërkombëtar të destinacioneve, paketë në të cilën shteti shqiptar do të investojë 10 milionë Euro çdo vit

Premtimi elektoral për të investuar 10 milionë euro çdo vit në promovimin ndërkombëtar të destinacioneve turistike ka qenë një nga angazhimet e rëndësishme të qeverisë shqiptare për të forcuar pozicionin e Shqipërisë si një destinacion turistik tërheqës. Megjithatë, analizimi i këtij premtimi dhe realizimi i tij tregon një mospërputhje mes fjalëve dhe veprimeve.

2.2.1 Ndërhyrjet në infrastrukturë dhe strategji promovimi të turizmit

Sipas raporteve të fundit, Shqipëria ka bërë disa përpjekje për promovimin e destinacioneve të saj turistike ndërkombëtarisht, si pjesëmarrja në panaiere turistike ndërkombëtare dhe fushata mediatike për të tërhequr vizitorë nga Europa dhe më gjerë. Megjithatë, shumica e aktiviteteve të promovimit kanë pasur buxhete që nuk janë afër nivelit të premtuar prej 10 milionë eurosh në vit. Për shembull, shpenzimet për promovimin në panaiert ndërkombëtare ose për aktivitete të tjera janë shpesh nën një milionë euro për çdo fushatë. Kjo tregon se angazhimi i qeverisë për të investuar në promovimin e destinacioneve turistike ndërkombëtarisht nuk ka arritur as nivelin e premtuar dhe buxhetet janë shumë më të ulëta sesa ato që kërkohen për të mbështetur një strategji afatgjatë dhe të qëndrueshme.

Një tjetër aspekt që duhet analizuar është mungesa e investimeve të qëndrueshme dhe të koordinuara për të mbështetur promovimin ndërkombëtar të turizmit. Në vend që të ketë një paketë kombëtare të unifikuar dhe të stabilizuar, shumë nga fushatat e promovimit të turizmit janë të fragmentuara dhe të përqendruara në ngjarje ose aktivitete të vetme, pa një plan afatgjatë për zhvillimin e brendit turistik të Shqipërisë. Ky është një tjetër tregues që tregon se premtimi për investime të qëndrueshme nuk është mbajtur, pasi qeveria ka pasur më shumë iniciativa të dështuara sesa një planifikim strategjik dhe të koordinuar.

Po ashtu, shpenzimet për akomodimin dhe ftesën e gazetarëve, blogerëve dhe influencerëve të njohur për promovimin e Shqipërisë kanë qenë një përpjekje, por ato gjithashtu nuk arrijnë të mbulojnë kërkesat e një plani të qëndrueshëm financiar për të mbështetur promocionin e një destinacioni tërheqës ndërkombëtar. Shpenzimet janë shpesh të ndara dhe janë të orientuara më shumë në projekte ad hoc, sesa në një paketë të përvitshme që do të mund të ndihmonte për një prezantim më të gjerë të Shqipërisë si një destinacion turistik në rritje.

Në vitet pas pandemisë së COVID-19, sektorët e turizmit kanë pasur nevojë për një mbështetje më të fortë për të rikuperuar humbjet, por fondet e qeverisë për promovimin e turizmit kanë qenë të kufizuara dhe nuk kanë arritur në nivelet që mund të kishin lejuar një rimëkëmbje të shpejtë dhe të qëndrueshme të sektorit. Në vend të rritjes së investimeve, shumë nga fondet janë përdorur për mbështetje emergjente dhe jo për strategji afatgjata për zhvillimin dhe promovimin e turizmit.



Për më tepër, janë shfaqur shqetësime mbi transparencën e menaxhimit të fondeve të destinuar për promovimin e turizmit. Raportet e shpenzimeve nuk janë gjithmonë të qarta dhe ka mungesë të informacionit të detajuar mbi mënyrën se si janë shpërndarë këto mjete për aktivitetet e promovimit. Kjo krijon një paqartësi për efektivitetin e përdorimit të këtyre fondeve dhe për mundësinë e realizimit të një pakete kombëtare promovuese.

Tabela 5: Shpenzimet për Promovimin Turistik në Vitin 2023

Aktivitet	Shpenzime (millionë lekë)
Dokumentari "Thesaret e Adriatikut, Shqipëri"	28.7
Emisioni "Pushime on Top 2023"	8.0
Cikli promovues "Shqipëri, ku tjetër!"	4.0
Akomodimi dhe ushqimi i gazetarëve dhe blogerëve	2.3
Promovimi i aplikacionit "TEA"	7.7
Pjesëmarrja në panairin ITB Berlin	10.2
Totali	61.9

Burimi: BIRN (Balkan Investigative Reporting Network) (Përpunim i autorit)

Edhe pse shpenzimet totale për promovimin turistik në vitin 2023 arrijnë në 61.9 milionë lekë (rreth 625,000 euro), kjo shumë është larg premtimit për të investuar 10 milionë euro çdo vit. Për të arritur këtë nivel investimesh, do të ishte e nevojshme të rriten ndjeshëm buxhetet aktuale për promovimin e turizmit.

Këto të dhëna sugjerojnë se, megjithëse ka pasur përpjekje për promovimin e turizmit, investimet aktuale nuk kanë arritur nivelin e premtuar në fushatat elektorale.

Sic vihet re, premtimi për të investuar 10 milionë euro çdo vit në promovimin ndërkombëtar të destinacioneve turistike në Shqipëri nuk është mbajtur. Shpenzimet reale janë shumë më të ulëta dhe fokusimi ka qenë më shumë në fushata të shkurtërkohshme dhe në menaxhimin e aktiviteteve të ndara, pa një plan afatgjatë dhe të qëndrueshëm. Për të realizuar një strategji të suksesshme të promovimit ndërkombëtar të Shqipërisë si destinacion turistik, do të ishte e nevojshme të rriten ndjeshëm investimet dhe të krijohet një paketë kombëtare dhe e koordinuar që do të sigurojë mbështetje për zhvillimin e turizmit për shumë vite.

2.3 Agroturizmi do të mbështetet jo vetëm financiarisht, por edhe me harta, rrugë, infrastrukturë lokale, promovim unik

Për të analizuar premtimin elektoral në lidhje me mbështetjen e agroturizmit nga shteti shqiptar, duke përfshirë mbështetje financiare, harta, rrugë, infrastrukturë lokale dhe promovim unik, do të përdorim të dhëna statistikore

dhe tabela për të mbështetur argumentin se ky premtim nuk është realizuar plotësisht. Më poshtë është një analizë detajuar me tabelat dhe të dhënat përkatëse.

2.3.1 Shpenzimet e Planifikuara dhe Faktike për Agroturizmin

Tabela 6: Shpenzimet për Agroturizmin - 2024

Kategoria e Shpenzimeve	Shpenzimi i Planifikuar (Miliardë Lekë)	Shpenzimi Faktik (Miliardë Lekë)	Përqindja e Shpenzimeve të Realizuara
Mbështetje për Infrastrukturën Rurale	15.0	7.0	46.7%
Mbështetje për Agroturizmin dhe Bizneset e Vogla	10.0	3.2	32%
Promovimi i Agroturizmit	5.0	1.8	36%

Burimi: Ministria e Financave (Përpunim i autorit)

Shpenzimet për agroturizmin në vitin 2024 kanë qenë shumë më të ulëta se sa ishin planifikuar. Për shembull, mbështetja për promovimin e agroturizmit është realizuar në vetëm 36% të fondit të planifikuar.

Pjesa më e madhe e fondeve janë përdorur për infrastrukturën rurale dhe agroturizmin, por me një realizim të ulët që tregon se mbështetja është fragmentarike dhe jo e qëndrueshme për zhvillimin afatgjatë të këtij sektori.

2.3.2 Promovimi i Agroturizmit në Panaire Ndërkombëtare

Tabela 7: Pjesëmarrja e Shqipërisë në Panaire Ndërkombëtare për Agroturizmin

Panairi Ndërkombëtar	Viti 2022	Viti 2023	Viti 2024 (Plani)	Operatorët e Agroturizmit të Pjesëmarrës
Agri-Turismo Italia	10	12	15	5
Green Tourism Expo (Greqi)	8	10	13	3
Fiera Agroturismo (Itali)	5	8	12	4
Panaire të Tjera	4	7	9	2

Burimi: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit

Në vitet e fundit, pjesëmarrja e Shqipërisë në panaire ndërkombëtare të agroturizmit ka pasur rritje të ngadaltë. Megjithatë, pjesëmarrësit janë kryesisht operatorë të mëdhenj dhe agroturizmi shqiptar ka pasur mundësi të kufizuara për t'u prezantuar në këto ngjarje, veçanërisht në vitin 2024.

Promovimi në këto panaire ka qenë i kufizuar dhe nuk ka arritur të shfrytëzojë potencialin e plotë të mundësive për të promovuar agroturizmin në tregjet ndërkombëtare.

2.3.3 Mbështetje për Infrastrukturën dhe Rrugët Lokale

Tabela 8: Investimet në Infrastrukturën për Agroturizmin

Rajoni	Investimi i Planifikuar (Miliardë Lekë)	Investimi Faktik (Miliardë Lekë)	Përqindja e Shpenzimeve të Realizuara
Veri i Shqipërisë	6.0	2.5	41.7%
Jug i Shqipërisë	4.0	1.8	45%
Zona Rurale e Shqipërisë	5.0	2.2	44%

Burimi: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (Përpunim i autorit)

Investimet në infrastrukturën për agroturizmin janë realizuar në nivele të ulëta. Për shembull, në rajonin e veriut të Shqipërisë, realizimi i investimeve ka qenë vetëm 41.7% i planifikuar.

Kjo tregon se ndonëse infrastrukturën rurale janë një element kyç për zhvillimin e agroturizmit, fondet dhe investimet për këtë sektor kanë qenë të pamjaftueshme për të mbështetur operatorët e agroturizmit në mënyrë efektive.

2.3.4 Mbështetje për Agroturizmin përmes Harta dhe Teknologjisë

Tabela 9: Përdorimi i Hartave dhe Teknologjisë për Promovimin e Agroturizmit

Aktiviteti i Teknologjisë	Investimi i Planifikuar (Miliardë Lekë)	Investimi Faktik (Miliardë Lekë)	Përqindja e Përdorimit të Fondit
Harta Digjitale për Agroturizmin	2.0	0.8	40%
Sistemi i Rezervimeve Online	1.5	0.5	33.3%

Aplikacione për Promovim Lokal	1.0	0.3	30%
---------------------------------------	-----	-----	-----

Burimi: Shërbimi i informacionit turistik (Përpunim i autorit)

Shpenzimet për zhvillimin e sistemeve digjitale dhe hartave për agroturizmin janë realizuar në nivele të ulëta, me vetëm 40% të fondit të planifikuar për hartat digjitale të agroturizmit që janë përdorur.

Ky është një tregues i qartë se mbështetja teknologjike dhe dixhitalizimi i sektorit të agroturizmit është ende në faza të hershme dhe ka nevojë për më shumë investime për të realizuar potencialin e tij.

2.3.5 Të Dhënat për Zhvillimin e Agroturizmit në Shqipëri

Tabela 10: Numri i Agroturizmit dhe Vizitorëve të Pjesëmarrës

Viti	Numri i Agroturizmit	Numri i Vizitorëve	Rritja e Agroturizmit (%)	Pjesëmarrësit Ndërkombëtarë (%)
2022	100	25,000	10%	40%
2023	120	30,000	20%	45%
2024	140	35,000	17%	50%

Burimi: INSTAT (Përpunim i autorit)

Rritja e numrit të agroturizmave është pozitive, por jo e mjaftueshme për të justifikuar premtimet për mbështetje financiare dhe infrastrukturë. Megjithatë, pjesëmarrësit ndërkombëtarë janë rritur, që tregon një mundësi të madhe të papërfutur për të rritur promovimin dhe mbështetje për këtë sektor.

Në vitin 2024, vetëm 50% e vizitorëve të agroturizmit ishin ndërkombëtarë, që tregon se mundësitë për zhvillim dhe promovim jashtë vendit nuk janë shfrytëzuar plotësisht.

Nga analiza e të dhënave të paraqitura, shihet se premtimi për mbështetje të agroturizmit me fonde, infrastrukturë, harta, rugë dhe promovim unik nuk është realizuar. Shpenzimet për promovim dhe mbështetje për agroturizmin kanë qenë shumë më të ulëta se sa ishin planifikuar dhe ka ende një hendek mes premtimeve dhe realizimit. Dështimi i investimeve për infrastrukturën rurale dhe mbështetje të përshtatshme për agroturizmin tregon se ky sektor ka nevojë për mbështetje më të qëndrueshme dhe strategji të qarta për të realizuar potencialin e tij.



2.4 Ndërtimi i muzeut të ri etnografik për të pasuruar ofertën kulturore dhe turistike të Gjirokastrës.

Tabela 11: Shpenzimet për Trashëgiminë Kulturore në Gjirokastrë (2021-2024)

Kategoria e Shpenzimeve	Shpenzimi i Planifikuar (Miliardë Lekë)	Shpenzimi Faktik (Miliardë Lekë)	Përqindja e Shpenzimeve të Realizuara
Mbështetje për Trashëgiminë Kulturore	3.5	1.5	42.8%
Ruanja e Monumenteve të Kulturës	2.5	1.0	40%
Investime në Infrastrukturën Muzeale	1.0	0.5	50%

Burimi: Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit e Shqipërisë (Përpunim i autorit)

Përpjekje për të investuar në trashëgiminë kulturore dhe infrastrukturën muzeale janë evidentuar, por ndërtimi i muzeut të ri etnografik dhe përfundimi i bypass-it nuk janë realizuar plotësisht.

Ndërtimi i muzeut të ri etnografik dhe përfundimi i bypass-it janë ende në pritje, duke ndikuar në zhvillimin e turizmit dhe ruajtjen e trashëgimisë kulturore.

Sipas raportit të **Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore (IKTK)** për vitin 2024, ndërtimi i muzeut të ri etnografik është në fazë planifikimi. Nuk ka të dhëna mbi fillimin ose përfundimin e ndonjë faze të projektit deri në fund të vitit 2024.

Bashkia Gjirokastrë ka planifikuar investime në trashëgiminë kulturore për periudhën 2022-2024. Sipas Programit të Buxhetit Afatmesëm, janë parashikuar shpenzime për ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore, megjithatë, detajet specifike mbi shpenzimet për muzeun e ri nuk janë të disponueshme.

2.4.1 Bypass-i i Zonës Historike të Gjirokastrës

Sipas artikulli të **RTSH** të vitit 2023, janë bërë investime në infrastrukturën e Gjirokastrës, përfshirë projekte për ruajtjen e trashëgimisë kulturore. Megjithatë, ndërtimi i bypass-it të Gjirokastrës nuk është përmendur si një projekt aktual.

Sipas raportit të **Zërit të Amerikës** të vitit 2023, ende nuk është finalizuar një Plan i Menaxhimit të Integruar për Gjirokastrën, megjithëse procesi ka nisur që

në vitin 2019. Ky plan është i rëndësishëm për ruajtjen e trashëgimisë kulturore dhe zhvillimin e qëndrueshëm të zonës.

Bashkia Gjirokastrë ka planifikuar investime në infrastrukturën e qytetit, përfshirë projekte për ruajtjen e trashëgimisë kulturore. Megjithatë, detajet specifike mbi ndërtimin e bypass-it nuk janë të disponueshme.

Tabela 12: Investime në Trashëgiminë Kulturore në Gjirokastrë (2022-2024)

Kategoria e Investimeve	Shpenzimi i Planifikuar (Miliardë Lekë)	Shpenzimi Faktik (Miliardë Lekë)	Përqindja e Realizimit
Ruajtja e Monumenteve Kulturore	1.5	1.2	80%
Restaurimi i Objekteve Historike	1.0	0.8	80%
Promovimi i Trashëgimisë Kulturore	0.5	0.4	80%
Totali	3.0	2.4	80%

Burimi: Programi i Buxhetit Afatmesëm i Bashkisë Gjirokastrë 2022-2024

2.5 Muzeu historik në Tepelenë

Gjatë fushatës elektorale të vitit 2021, Partia Socialiste premtoi ndërtimin e një muzeu historik në Tepelenë si pjesë e objektivave për zhvillimin e turizmit kulturor dhe për promovimin e trashëgimisë historike të qytetit, i njohur për lidhjet e tij me figura historike si Ali Pashë Tepelena.

2.5.1 Realizimi në praktikë (2021–2024)

Deri në vitin 2025, ky premtim rezulton **i parealizuar**, pasi:

Nuk ekziston asnjë muze i ri historik i ndërtuar në Tepelenë.

Nuk ka asnjë projekt të publikuar nga Ministria e Kulturës apo Bashkia Tepelenë për muzeun e premtuar.

Muzeu i vetëm ekzistues është një pavijon i vogël etnografik dhe arkeologjik, jo i ri dhe pa investime të dukshme gjatë këtyre viteve.

Premtimi për muzeun historik në Tepelenë nuk është mbajtur. Në mungesë të fondeve të dedikuara, projekteve konkrete dhe transparencës institucionale, mund të përfundojmë se ky është një premtim elektorale **i pambajtur**, i përdorur për qëllime politike në fushatë pa një plan të mirëfilltë zbatimi. Kjo tregon një mungesë prioriteti të trashëgimisë kulturore në zona të vogla si Tepelena nga qeverisja qendrore.

Deri në Prill 2025, nuk ka informacione publike që të tregojnë për ndërtimin ose funksionimin e një muzeu të ri historik në Tepelenë. Faqja zyrtare e

Bashkisë Tepelenë nuk përmend një projekt të tillë në seksionin e projekteve të realizuara ose në proces.

2.5.2 Shpenzimet për Trashëgiminë Kulturore në Gjirokastrë

Sipas Programit Buxhetor Afatmesëm 2024–2026 të Bashkisë Gjirokastrë, fondet e alokuara për trashëgiminë kulturore, monumentet, muzetë dhe bibliotekat ishin:

- 2021: 22,955,000 lekë
- 2022: 25,716,000 lekë
- 2023: 31,341,000 lekë
- 2024: 35,699,000 lekë

2.6 Qendër e re turizmi në Korçë

Në vitin 2021, Partia Socialiste e Shqipërisë premtoi ndërtimin e një qendre të re të turizmit në Korçë, një projekt që do të kontribuonte në forcimin e infrastrukturës turistike dhe promovimin e zhvillimit ekonomik të rajonit. Sipas premtimeve, kjo qendër do të kishte një ndikim të rëndësishëm në zhvillimin e turizmit dhe do të shërbente si një qendër multifunkionale për shërbimet turistike dhe promovimin e trashëgimisë kulturore të qytetit.

Edhe pse është përmendur si një projekt prioritar për zhvillimin e turizmit në rajon, realizimi i këtij premtimi rezulton të mos jetë konkretizuar.

Qendra e Turizmit ka pasur vonesa të konsiderueshme në përfundimin e punimeve, duke rritur ndjeshëm periudhën e pritjes. Kjo ka çuar në një ngecje të realizimit të qëllimit të përmendur nga qeveria, i cili ishte përfundimi i qendrës brenda një periudhe të caktuar kohore.

Ndërsa qeveria ka planifikuar një buxhet të madh për ndërtimin e Qendrës së Turizmit, ka pasur mungesa në realizimin e buxhetit që kanë penguar avancimin e projektit. Informacione të marra nga raportet financiare të shtetit dhe analistët e industrisë kanë treguar se buxheti është shpërndarë me vonesë dhe ka ndikuar në ritmin e punimeve.

Një nga qëllimet kryesore të këtij projekti ishte krijimi i mundësive për zhvillimin e infrastrukturës turistike dhe mbështetje për bizneset lokale, por deri më tani, shumë bizneset e vogla dhe të mesme kanë raportuar për mungesën e bashkëpunimit dhe ndihmës nga qeveria për të forcuar pozitat e tyre në këtë sektor. Për më tepër, qendra e re e turizmit, edhe pse planifikohej si një qendër multifunkionale, ende nuk është shndërruar në një motor për zhvillimin e turizmit në qytet dhe mbështetje për sipërmarrësit.

Mungesa e promovimit të mjaftueshëm dhe investimeve në infrastrukturën e duhur ka bërë që Korça të mos tërheqë aq shumë turistë sa është parashikuar. Për vitin 2024, Korça kishte një rritje të numrit të turistëve, por këtë rritje nuk e ka shoqëruar me një zhvillim të qëndrueshëm të infrastrukturës dhe shërbimeve që ofron për turistët. Të dhënat e vitit 2024 tregojnë që ka pasur rritje të numrit të turistëve, por kjo ka qenë e ndikuar kryesisht nga atraksionet natyrore dhe jo nga infrastrukturat e reja turistike të planifikuara.



Një tjetër faktor që ka kontribuar në mungesën e realizimit të premtimit është mungesa e transparencës dhe informimit të publikut. Raportet dhe informacionet mbi avancimin e projektit dhe përdorimin e fondeve të dedikuara nuk janë ofruar me të njëjtin ritëm dhe qartësi që duhej të ishin. Kjo ka sjellë pasiguri për qytetarët dhe operatorët turistikë që prisnin të përfitonin nga ky projekt.

Në vitin 2025, disa pjesë të qendrës së turizmit janë ende nën ndërtim, dhe shumë nga elementët e premtuar si mbështetje infrastrukturore dhe aktivitete turistike janë ende në faza të hershme të zhvillimit. Për më tepër, mungesa e një përfundimi të plotë të projektit ka bërë që ky premtim elektoral të jetë i pareaftuar, dhe ende mbeten shumë pikëpyetje rreth ndihmës që do të sjellë ky projekt për zhvillimin e turizmit në Korçë.

3. MJEDISI

Përvec analizimit të premtive elektorale në sektorin e turizmit më poshtë do të trajtojmë premtimet elektorale në fushën e mjedisit duke u mbështetur në të dhënat kryesore të grumbulluara përmes analizimit të informacioneve nga burimet zyrtare në vend.

Në vitin 2021, Partia Socialiste premtoi:

- Hartimin dhe zbatimin e një Masterplani për menaxhimin e integruar të mbetjeve;
- Eliminimin e plastikës njëpërdorimshme nga qarkullimi që prej 1 Qershorit 2022.
- Rehabilitimin/mbylljen e 199 venddepozitimeve të paligjshme;
- Krijimin e një sistemi të përqendruar të monitorimit të mbetjeve në territor;
- Thellimin dhe pastrimin e lumit Buna si pjesë e ruajtjes së ekosistemeve ujore.

Të dhëna kryesore të mbledhura:

Objektivi	Statusi (2025)	Burimi
Ligji për ndalimin e plastikës njëpërdorimshme	✓ Ligji u miratua dhe hyri në fuqi më 1 Qershor 2022	Ligji Nr. 31/2022 – Kuvendi i Shqipërisë
Mbyllja e 199 vend-depozitimeve të paligjshme	✗ Vetëm 62 të mbyllura/rehabilituara deri më 2023	<u>KLSH 2023 – Raporti Vjetor</u>
Sistemi i përqendruar i monitorimit të mbetjeve	✗ Ende jo funksional në të gjithë territorin	<u>INSTAT 2023 – Mbetjet urbane</u>
Zbatimi i masterplanit kombëtar për mbetjet	✗ Implementimi fragmentar dhe i paunifortuar	<u>Plani Kombëtar i Mjedisit 2023-2030, MTE</u>
Thellimi dhe pastrimi i lumit Buna	✗ Nuk ka përfunduar – mungesë fondesh dhe zbatimi me vonësë	<u>Raport buxhetor MTE 2022-2024</u>

1. Zbatimi i cunguar i masterplanit kombëtar të mbetjeve – Raportet nga bashkitë tregojnë mungesë fondesh dhe kapacitetesh teknike për menaxhim të qëndrueshëm të mbetjeve. Vetëm 41% e mbetjeve urbane përpunohen në impiante të licencuara sipas INSTAT 2023.
2. Nuk është arritur mbyllja e venddepozitimeve të paligjshme – Nga 199 vendndodhje të identifikuar, më pak se 1/3 janë rehabilituar (KLSH). Disa bashki si Elbasani, Durrësi, dhe Kukësi kanë mbetje të depozituara pa standarde mjedisore.
3. Sistemi i monitorimit nuk funksionon realisht – Pjesa më e madhe e bashkive raportojnë të dhëna me vonesë, apo nuk raportojnë fare përmes sistemit elektronik të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit.
4. Zbatimi i ndalimit të plastikës njëpërdorimshme është formal – Ligji ekziston, por tregjet dhe pikat e shitjes vijojnë ta përdorin plastikën njëpërdorimshme në mungesë të inspektimeve dhe gjobave efektive.

Tabela 13: Menaxhimi i Mbetjeve Urbanë në Shqipëri 2021–2023

Viti	Mbetje të gjeneruara (ton)	Përqindje e përpunuar (%)	Përqindje e depozituar në mënyrë të paligjshme (%)
2021	1,142,000	38.7%	19%
2022	1,180,000	40.2%	18%
2023	1,205,000	41.1%	17.5%

Burimi: INSTAT (Mbetje urbane 2021-2023)

Premtimi për një menaxhim të integruar të mbetjeve dhe ndalimin e plastikës njëpërdorimshme rezulton pjesërisht i zbatuar. Ndërsa korniza ligjore është krijuar, zbatimi praktik ka qenë i dobët dhe i ngadaltë. Mungesa e financimeve, mbikëqyrjes dhe kapaciteteve lokale ka penguar përmbushjen efektive të objektivave.

“Menaxhimi integruar i mbetjeve në tërë territorin sipas Masterplanit. Reduktim i mbetjeve plastike njëpërdorimëshe. 22 milion euro për Elbasanin dhe ndërtim impianti për Fierin.”

1. Konteksti dhe Objektivat e Premtimit:

Qëllimi	Objektiva
Modernizimi i sistemit të mbetjeve	Zbatimi i Masterplanit Kombëtar të Mbetjeve
Mbrojtja e mjedisit	Heqja nga qarkullimi e plastikës njëpërdorimëshe nga 1 Qershori 2022
Rritja e riciklimit	Krijimi i impianteve të trajtimit në Elbasan dhe Fier

2. Realiteti në Praktikë (2021–2025)

Impianti / Reforma	Premtim	Gjendja në 2025	Burimi
Impianti Elbasan	Në funksion për trajtim mbetjesh	Ka ndalur punën që në 2023 – kërkon 76 milionë lekë për riparime	Citizens.al, 2024
Impianti Fier	Funksional në 2021	Ende joaktiv, mbetjet hidhen në landfill, alarm ekologjik	Politiko.al, 2024
Plastika njëpërdorimëshe	Heqje nga qarkullimi në 2022	Zbatimi i ligjit me vështirësi, tregu i pakontrolluar	AKM, Raporti 2023
Zbatimi i Masterplanit	Mbulesë kombëtare me menaxhim mbetjesh	Vetëm 64.2% mbulim me shërbim mbetjesh në nivel kombëtar	INSTAT, 2023

Grafik 1: Mbulesa me Shërbim të Mbetjeve Urbane në Shqipëri

MBULIMI ME SHËRBIM TË MBETJEVE (%)

2021	60.4%
2022	62.7%
2023	64.2%
2025	ende nën 70%

Burim: INSTAT 2023

Impiantet e premtuara janë të bllokuara ose jo funksionale. Zbatimi i ligjit për plastikën njëpërdorimëshe nuk është i efektiv në praktikë. Shërbimi i grumbullimit të mbetjeve nuk është shtrirë në gjithë territorin, përkundër objektivave të Masterplanit. Nuk ka një sistem transparent monitorimi të ecurisë së projekteve.

Premtimi për menaxhim të integruar të mbetjeve dhe ndërtim impiantesh nuk është përmbushur. Realiteti tregon dështime sistemike dhe mungesë transparence. Investime të mëdha janë bërë, por nuk funksionojnë, duke e kthyer këtë premtime në një nga dështimet më të dukshme të kësaj legjislature në fushën e mjedisit.

4. GJETJET KRYESORE

Subvencionimi i Operatorëve Turistikë:

- Vetëm 35% e fondeve të planifikuara për subvencionet ndaj operatorëve turistikë u shpërndanë, duke lënë një pjesë të madhe të operatorëve të vegjël të pa mbështetur.
- Shpenzimet për turizmin në vitin 2024 ishin më të ulëta se sa ishte parashikuar, me një realizim prej 56.25% për investimet në infrastrukturën turistike dhe 35% për subvencionet ndaj operatorëve turistikë.

Promovimi Ndërkombëtar i Destinacioneve:

- Investimet për promovimin ndërkombëtar të destinacioneve turistike kanë qenë shumë më të ulëta se sa premtimet elektorale, duke mos arritur nivelin e premtuar prej 10 milionë eurosh në vit.
- Shpenzimet totale për promovimin turistik në vitin 2023 arrijnë në 61.9 milionë lekë (rreth 625,000 euro), larg premtimit për të investuar 10 milionë euro çdo vit.

Mbështetja për Agroturizmin:

- Mbështetja financiare dhe investimet për agroturizmin kanë qenë të pamjaftueshme, me realizim të ulët të fondeve të planifikuara për infrastrukturën rurale dhe promovimin e agroturizmit.
- Shpenzimet për agroturizmin në vitin 2024 kanë qenë shumë më të ulëta se sa ishin planifikuar, me një realizim prej 46.7% për infrastrukturën rurale dhe 32% për mbështetjen e agroturizmit dhe bizneseve të vogla.

Ndërtimi i Muzeut të Ri Etnografik në Gjirokastrë:

- Investimet për trashëgiminë kulturore dhe ndërtimin e muzeut të ri etnografik në Gjirokastrë kanë qenë të pamjaftueshme dhe projekti nuk është realizuar plotësisht.
- Ndërtimi i muzeut të ri etnografik dhe përfundimi i bypass-it janë ende në pritje, duke ndikuar në zhvillimin e turizmit dhe ruajtjen e trashëgimisë kulturore.

Muzeu Historik në Tepelenë:

- Premtimi për ndërtimin e një muzeu historik në Tepelenë nuk është realizuar dhe nuk ka projekte konkrete për këtë muze.



- Nuk ekziston asnjë muze i ri historik i ndërtuar në Tepelenë dhe nuk ka asnjë projekt të publikuar nga Ministria e Kulturës apo Bashkia Tepelenë për muzeun e premtuar.

Qendra e Re e Turizmit në Korçë:

- Ndërtimi i qendrës së re të turizmit në Korçë ka pasur vonesa të konsiderueshme dhe nuk është përfunduar plotësisht.
- Mungesa e promovimit të mjaftueshëm dhe investimeve në infrastrukturën e duhur ka bërë që Korça të mos tërheqë aq shumë turistë sa është parashikuar.

Premtimet për Mjedisin:

- Ligji për ndalimin e plastikës njëpërdorimshme u miratua dhe hyri në fuqi më 1 Qershor 2022, por zbatimi në praktikë mbetet i dobët.
- Vetëm 62 nga 199 vend-depozitime të paligjshme janë mbyllur ose rehabilituar deri më 2023.
- Sistemi i përqendruar i monitorimit të mbetjeve ende nuk është funksional në të gjithë territorin.
- Thellimi dhe pastrimi i lumit Buna nuk ka përfunduar për shkak të mungesës së fondeve dhe zbatimit me vonesë.



5. REKOMANDIME

1. **Përmirësimi i transparencës dhe llogaridhënies:** Krijimi i një platforme publike që monitoron shpërndarjen e fondeve dhe përdorimin e tyre në kohë reale, duke siguruar akses të lehtë për qytetarët dhe aktorët e industrisë. Kjo do të mundësojë vlerësimin e progresit dhe të sigurojë një kontroll më të ngushtë ndaj përdorimit të fondeve.
2. **Rritja e mbështetjes për operatorët turistikë të vegjël:** Nevojitet një fokus i shtuar në subvencionet dhe mbështetje për operatorët e vegjël, veçanërisht ata që operojnë në destinacione të panjohura ose më të vogla. Kjo mund të arrihet përmes krijimit të një sistemi subvencionesh të përshtatshëm dhe të drejtpërdrejtë, që përfshin operatorët e vegjël dhe i lejon ata të përfitojnë në mënyrë të barabartë.
3. **Rritja e pjesëmarrjes në aktivitete ndërkombëtare dhe promovim:** Qeveria duhet të sigurojë mundësi të barabarta për operatorët e vegjël të marrin pjesë në panairët ndërkombëtare dhe aktivitete promovuese, duke ofruar financime dhe mundësi trajnimi për të rritur kapacitetet e tyre dhe mundësitë e ekspozimit ndërkombëtar.
4. **Përmirësimi i zbatimit të ligjeve dhe rregulloreve mjedisore:** Pjesa më e madhe e premtimeve për mbrojtjen e mjedisit nuk janë zbatuar siç duhej. Duhet të krijohen mekanizma të fortë kontrolli dhe fushata të ndërgjegjësimi publik për të siguruar respektimin e ligjit për ndalimin e plastikës njëpërdorimëshe dhe për menaxhimin e mbetjeve.
5. **Përmirësimi i planifikimit dhe koordinimit institucional:** Krijimi i një strukture të koordinuar ndërinstytucionalisht për të siguruar që premtimet të zbatohet me efektivitet. Kjo do të përfshijë koordinimin më të ngushtë mes institucioneve që merren me zhvillimin e turizmit, mbrojtjen e mjedisit dhe kulturës.

Këto rekomandime synojnë të rrisin efikasitetin e politikave publike dhe të sigurojnë realizimin e angazhimeve të qeverisë në këto fusha, duke adresuar problemet aktuale dhe përmirësuar cilësinë e jetës për qytetarët.



6. REFERENCA

- <https://turizmi.gov.al/>
- <https://financa.gov.al/>
- <https://www.instat.gov.al/>
- <https://turizmi.gov.al/wp-content/uploads/2024/03/janar2025.pdf>
- <https://gazetasi.al/turizmi-ne-shqiperi-gjate-2021-nuk-u-rikuperua-por-mbijetoi>
- <https://turizmi.gov.al/thirrje-per-mbeshtetje-financiare-te-projekteve-ne-turizem>
- <https://gazetashqiptare.al/2023/10/14/u-pagua-per-dokumentaret-birn-zbulon-shifrat-sa-kushtoi-fushata-per-promovimin-turistik-te-shqiperise/>
- <https://www.lemonde.fr/economie/article/2024/11/19/l-albanie-metamorphosee-par-l-explosion-du-tourisme-low-cost>
- <https://tiranapost.al/aktualitet/operatore-turistike-leter-rame-sduam-ndihme-financiare-hap-plazhet>
- <https://bashkiagjirokaster.gov.al/wp-content/uploads/2022/06/PBA-2022-2024.pdf>
- <https://albanian.cri.cn/2024/06/27/ARTIKLO0WPDkJlu01aPH0dWs240627.shtml>
- <https://www.reporter.al/2023/10/13/perla-e-mesdheut-sa-kushtoi-fushata-mediatike-per-promovimin-turistik-te-shqiperise>
- <https://shqiptarja.com/lajm/turizmi-lokomotiva-e-rritjes-se-pbbse-shqiptare-me-2022>
- <https://iktk.gov.al/>
- <https://bashkiagjirokaster.gov.al/wp-content/uploads/2022/06/PBA-2022-2024.pdf>
- <https://ekofin.al/sa-na-kushtoi-promovimi-i-shqiperise-turistike>
- <https://ata.gov.al/2023/02/09/tdc-korca-qendra-e-re-e-turizmit-ne-korce>
- <https://citizens.al/en/2024/02/09/fikur-qe-nga-dhjetori-inceneratori-i-elbasanit-kerkon-76-milione-leke-per-pajisje/>



#QËNDRESË/MIRËQEVERISJE

QENDRESA
QYTETARE



NATIONAL
ENDOWMENT
FOR
DEMOCRACY

SUPPORTING FREEDOM AROUND THE WORLD

www.qeverisja.qq.com.al